

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

"Blerje oksigjen i gazte dhe i lengshem" i ndare ne dy lote (*Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomikë - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 mujor*). *perkatesisht*

Lot. 1 – Oksigjen i gazte

Lot. 2 - Oksigjen i lengshem.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

24112200-4 - Oksidet e azotit

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-16655-08-20-2024

Lot. 1 – Oksigjen i gazte : **REF-16659-08-20-2024**

Lot. 2 - Oksigjen i lengshem: **REF-16662-08-20-2024**

VLERA E FONDIT LIMIT:

Vlera e pritshme e kontratave total per te dy lotet : 17 979 732.4 (shtatembdhjete million e nenteqind e shtatedhjte e nente mije e shtateqind e tridhjte e dy pike kater) leke **pa TVSH** me burim financimi : **Buxheti i Shtetit perkatesisht :**

Vlera e pritshme e kontrates per Lot. 1 – Oksigjen i gazte : **1 240 512** (nje milion e dyqind e dyzete mije e peseqind e dymbedhjte) lekë pa TVSH;

Vlera e pritshme e kontrates per Lot. 2 - Oksigjen i lengshem : **16 739 220.4** (gjashtembdhjte milion e shtateqind e tridhjte e nente mije e dyqind e njezete pike kater) lekë pa TVSH

Burimi i Financimit : Buxheti i Shtetit Kjo procedure eshte deleguar per tu kryer nga Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale me shkrese nr.746.prot date 07.02.2024 “udhezim mbi kryerjen e disa procedurave teprokurimit publik administruar prane Autoritetit kontraktor me nr.545, date 09.02.2024.”

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Spitali Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Objekti i kontrates

Blerje oksigjen i gazte dhe i lengshem" i ndare ne dy lote *i ndare ne dy lote perkatesisht*

Lot. 1 – Oksigjen i gazte

Lot. 2 - Oksigjen i lengshem

Kontrata është ndare në dy lote konform të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 42, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe duke marrë parasysh dhe praktiken e mëparshme të zhvilluar nga MSHMS në rolin e organit qendror bleres

TE NJEJTA PER TE DY LOTET

1- Kriteri i përzgjedhjes së fituesit:

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Operatori ekonomik, në plotësimin e formularit të ofertës duhet t'i referohet Fondit Limit Kontratës. Tejkalimi mbi fondin e përcaktuar të Kontratës është kusht skualifikues.

Kriteri i përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar bazuar në nenin 87, pika 1, 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 45 pika 1,2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

Fondit limit total për të dy lotet : 17 979 732.4 (shtatëmbëdhjetë milion e nentëqind e shtatëdhjetë e nente mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy pike kater) leke **pa TVSH**

Fondi limit është perlllogaritur bazuar në V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar nëni 76 në titullin “Mënyrat për perlllogaritjen e vlerës së prokurimit” pika 1. Në perlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon: germa a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

Ne rastin aktual Perlllogaritja e vlerës limit të kontratës është bazuar në çmimet e dhena nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresë nr.746.prot date 07.02.2024 “udhezim mbi kryerjen e disa procedurave të prokurimit publik administruar pranë Autoritetit kontraktor me nr.545, date 09.02.2024 pasqyruar në procesverbalin e perlllogaritjes së fondit limit nr 3303, date 08.07.2024 si dhe Kërkeses nr 3249 date 02.07.2024 të Sektorit Teknik

I. ARGUMENTIM I KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR LOT. 1 – Oksigjen i gazte

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1;
- d. Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

- a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;
b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne të cilin është e parashikuar se:

1. *Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*
2. *Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

d. Lista e cmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: *Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipercituar.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 29, 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të përlogaritur për këtë lot.

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera do të aplikohet mbi vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar si dhe bazuar në vlerën e fondit limit të këtij loti

Ky kriter, është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës pasi shërben si tregues për kapacitetin financiar të operatorëve ekonomik.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar bazohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar, nenit 43 pika 1 dhe pika 2 germa ”c”, parashikohet marzhi maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në prokurimit nën kufirin e ulët monetar, konkretisht:

Neni 43 Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

1. *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*
2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë*
c) *40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' i ndryshuar ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; si dhe në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2023, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë afat deri më 31.03.2024. (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore)

Gjithashtu ky kriter është vendosur bazuar në VKM-se nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar Neni 42 "Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote" pika 3 dhe pika 9

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20% e vlerës së këtij loti.**

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Permbushja e njerit prej kriterëve të mesiperm e ben oferten te vlefshme

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me Ligjin nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar nenin 77 pika 4 ku përcaktohet se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; neni 40 pika 4 dhe në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, dhe vlera e kërkuar është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :

Në bazë të VKM-se nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 40 pika 4 ku citohet se "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas

kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.” dhe neni 55, pika 4/b ku citohet se: “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, dhe vlera e kërkuar është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri ka për qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontrates sic është parashikuar nga AK pasi në rastin aktual kemi të bëjmë me materiale mjekimi të një natyre teper të vecante

Gjithashtu ky kriter është vendosur bazuar në VKM-se nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Neni 42 “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote” pika 3 dhe pika 9

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontrates sic është parashikuar nga AK

2.3.2 Certifikate ISO 9001-2015 ose ekuivalent, të vlefshme, për distribucionin e gazrave mjekesore të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, për fushën e aktivitetit të OE/ që perkon/ përputhet me objektin e Prokurimit

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, ku përcaktohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter është në përputhje dhe me piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës. Gjithashtu ky kriter gjë mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”. Gjithashtu ISO 9001: 2015 përfaqëson standartin ndërkombëtarë unanim i njohur si standarti që i perket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë, specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, për një organizatë e cila duhet të demonstrojë aftësinë e saj për të ofruar vazhdimisht produkte dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve dhe të zbatueshme ligjore dhe rregullatore, dhe ka për qëllim të rrisë kënaqësinë e klientit përmes zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e sistemit dhe sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat e konsumatorëve dhe kërkesat ligjore dhe rregullative). Të gjitha kërkesat e ISO 9001: 2015 janë të përgjithshme dhe kanë për qëllim të jenë të zbatueshme për çdo organizatë, pavarësisht nga lloji ose madhësia, ose produktet dhe shërbimet që ofron. Në rastin aktual është vendosur konform objektit të prokurimit.

2.3.3 Certifikate ISO 45001-2018, të vlefshme, për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, ku përcaktohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të

konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter është ne perputhje dhe me piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”. ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret furnizimi i gazrave mjekesore objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.4 Certifikatë ISO 14001:2015 –Sistemi i menaxhimit mjedisor ose ekuivalent, të vlefshme, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Argumentimi: Ky kriter është vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, ku percaktohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter është ne perputhje dhe me piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”. ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret furnizimi me gazra mjekesore objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim, te vlefshem i leshuar nga Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion) ose organet kompetente per kolaudimin dhe plotësimin e kushteve teknike dhe te sigurisë per bombolat te oksigjenit/ ose/ te leshuar nga prodhuesi per rastin kur bombolat jane te reja, konform legjislacionit ne fuqi per enët nën presion.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 te Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe me piken 8 të nenit 40 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku percaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës” si dhe konform ligjit nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve

dhe instalimeve nën presion” nenet 12, 13. Është vendosur duke patur parasysh se kemi të bëjmë me gazra mjekësore dhe shërben si element sigurie në mbarevajtjen e furnizimit me këto artikull të rëndësishëm dhe jetik në mbarevajtjen e punës së AK.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon gjendje bombola oksigjeni mjekësor / pako bombola, në pronësi ose me qira, minimumi 100 bombola. Për të vërtetuar këto kriter, operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi për pronësinë mbi këto bombola (dokument doganor për importimin e bombolave të oksigjenit) ose kontratën e qirase përkatëse bashkëngjitur dokumentin e pronësive (dokument doganor për importimin e bombolave të oksigjenit) të qiradhenesit ose çdo lloj dokumenti tjetër ligjor i cili dëshmon disponimin në pronësi të këtyre bombolave.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në mbështetje të pikës 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe me pikën 8 të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar dhe behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet pasjes së burimeve/kapaciteteve të mjaftueshme për furnizimin me sasine dhe llojin e kërkuar nga AK dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar në DST.

2.3.7 Kërkohej Autorizim (i vlefshëm për periudhën 2024 - 2025), lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit) ose nga Distributori i Autorizuar, nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tij në vendin tonë. Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe ligjin **nr.105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” neni 11 pika 1**. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Autorizim prodhuesi për tregtim të materialeve objekt prokurimi, që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë furnizimin e mallrave objekt prokurimi në mënyrë cilësore sic parashikohen nga legjislacioni në fuqi dhe që vlerësohet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Autorizim prodhuesi është dokumenti që i lëshohet prodhuesit farmaceutik, pasi ky i fundit ka vërtetuar se prodhuesi farmaceutik ka përmbushur të gjitha standardet e prodhimit, të cilësisë, ruajtjes dhe shpërndarjes së barit., pra është element sigurie për mallrat objekt prokurimi.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese/MAH ose distributor i autorizuar. Të plotësohet në shtojcën 2, Lista e çmimeve të artikujve ose të paraqesë një deklaratë e vecante mbi origjinën e mallit (Firma prodhuese ose distributori i autorizuar dhe vendi i prodhimit/origjinës.).

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancojë se furnizimit të mallit objekt prokurimi, pasi në rastin aktual kemi të bëjmë me medikament i cili është i një natyre tepër të vecante.

2.3.9. Për barnat (e listës së DST) të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

/ose/

- autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe ligjin **nr.** “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, neni 11 në

pika 1 ku citohet: *1. Barnat që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë për përdorim njerëzor duhet të jenë të pajisura me autorizim për tregtim nga Agjencia.*

2.3.10. Për barnat (e listës së DST) të paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, bari që ofertohet duhet:

- a. të ketë marrë autorizim për tregtim dhe të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar;
/ose/
- b. të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm nëse ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tij,
/ose/
- c. të jetë i pajisur me autorizim për tregtim nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA), ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Për këtë kërkohet që ofertuesi të paraqesë:

- Deklaratë me anën e të cilës të konfirmohet se bari që ofron, është i pajisur me autorizim për tregtim dhe qarkullon në një nga vendet e mësipërme (të Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar), ose që disponon autorizim për tregtim nga FDA ose EMA.

Në deklaratën e nëshkruar dhe të vulosur nga ofertuesi duhet të deklarohen: Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/eve të autorizuar që kanë lëshuar autorizimin për tregtim; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail, web-site); Numri dhe data e lëshimit të autorizimit për tregtim (nga Institucioni/et të autorizuar) të barit që ofron dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi.

Argumentim: Ky kriter vendoset në zbatim të Nenit 11, pika 2, të Ligjit Nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, e cila, parashikon:

"2. Në raste nevojash të shërbimit shëndetësor (për mjekim ambulator dhe/ose spitalor), për barna të cilat nuk kanë asnjë alternativë të ngjashme, e cila ka autorizim për tregtim nga Agjencia, ministri përgjegjës për shëndetësinë autorizon importimin e barnave, për të cilat nuk është lëshuar autorizim tregtimi nga Agjencia, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave".

Gjithashtu, me qëllim garantimin e përmbushjes së standardeve mbi sigurinë, cilësinë dhe efikasitetin e barnave, edhe në rastin e barnave të paautorizuara, janë aplikuar të njëjtat kërkesa mbi origjinën e tyre, sikurse për barnat e autorizuar për tregtim. Kjo, duke u bazuar në Nenin 12, pika 2, të Ligjit Nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, e cila parashikon:

"2. Agjencia i propozon ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhënien e autorizimit të tregtimit për:

- a) barnat e prodhuara në vendin tonë;
- b) barnat që kanë marrë autorizim për tregtim dhe që qarkullojnë në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar;
b/1) barnat që kanë marrë autorizim për tregtim lokal dhe që qarkullojnë në vend, duke përmbushur përcaktimet e shkronjës "b" të pikës 2 të këtij neni."
- c) barnat e prodhuara në vendet e Ballkanit, vetëm kur kanë marrë autorizim për tregtim dhe qarkullojnë në vendin e tyre;
- ç) barnat e pajisura me autorizimin e tregtimit nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës."

Në bazë të të dhënave të deklaruara , KVO është në gjendje të bëjë verifikimin e tyre.

2.3.11 Për barnat e parashikuara në pikën 2.3.9 të KVK të DST, kërkohet Autorizim (i vlefshëm për periudhën 2024 - 2025), lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tij në vendin tonë.

2.3.12 Për barnat e parashikuar në pikën 2.3.10 të KVK të DST, kërkohet Autorizim (i vlefshëm për periudhën 2024 - 2025), lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit) ose prodhuesi, ose distributori i autorizuar, nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre në vendin tonë.

Shënim: Në rastin e autorizimeve të lëshuara nga distributorët e autorizuar, duhet të provohet me dokumente lidhja e tyre (distributorëve të autorizuar) me prodhuesin/MAH (mbajtësin e autorizimit të tregtimit).

Argumentim: Përsa i përket **kritereve 2.3.11 dhe 2.3.12** vendosen në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar (aftësia teknike), si dhe pika 3 e nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me qëllim zotërimin e reputacionit dhe besueshmërisë për zbatimin e kontratës. Afati i vlefshmërisë së autorizimit vendoset në përputhje me kohëzgjatjen e MK. Keto kërkesa dhe vecanerisht lidhja me distributorin për barnat e pa autorizuar për tregtim në RSH, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

Argumentimi i specifikimeve teknike LOT. 1 – OKSIGJEN I GAZTE

LOT 1 Oksigjen i gazte

1	2	3	4	5	6
Nr	Sistemi	Principi aktiv	Formë doza	Njësia	Sasia e pritshme për 12 muaj
Lot 1.	Anestezi reanimacion	Oksigjen i gazte	Gaz për përdorim mjekësor, i kompresuar x 100%	Litra	38 766

Sasitë e pritshme të shënuara janë të përafërta, llogaritur për një periudhë 12 mujore (1 vit), dhe nuk janë në asnjë mënyrë detyruese për Autoritetin Kontraktor. Ato janë vendosur me qëllim vlerësimin e njëjtë të të gjitha ofertave të Operatorëve Ekonomikë.

1. PER OKSIGJENIN MJEKËSOR GAZ

Oksigjen	O2	99,50 %
Monoksid karboni	CO	0.13 vmp (volum për milion)
Bioksid Karboni	CO2	0.11 vpm
Ujë	H2O	0.06 vpm

Kushtet e furnizimit. LOT 1 OKSIGJEN GAZ do behet me bombola 40 litra sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor

Presioni i mbushjes së bombulave të jete jo më pak se 125 bar.
Sasia e oksigjenit në bombola të jete 40 litra për presion 125 bar.
Ambalazhimi të jete në vëllim 40 litra.
Ambalazhimi i oksigjenit për përdorim mjekësor të jete në bombulat e shitesit
Bombulat të këna shënjën dalluese “ për përdorim spitalor” (O2)

Bombolat e oksigjenit duhet të shoqerohen me vertetimin e kryerjes së kontrolleve periodike të **Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial** (Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion) ose/ **organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe të sigurisë, për enët nën presion tankera/serbatores/cisterna**, sipas përcaktimeve ligjore.

Transporti i bombolave të oksigjenit mjekësor, i kompresuar, duhet të bëhet me automjete të pajisur me :

Furnizimi.

- Transporti i bombolave te oksigjenit mjekësor, i kompresuar, duhet te bëhet me automjete të pajisur me çertifikatë ADR te lëshuar nga DPSHTRR.
- Leje për Transport gazra mjekësore nën presion, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.
- Transportimi dhe shkarkimi i mallit është përgjegjesi e shitësit
- Furnizimi bëhet sipas kërkesave dhe nevojave faktike të Autoritetit Kontraktor për këtë artikull, bazuar në kontratat e lidhura gjate gjithë periudhës së vlefshmerisë së Marrveshjes Kuadër. Në cdo rast duhet lajmëruar furnizuesi dy ditë më parë.
- Për arsye të krijimit të një sigurie në kryerjen e furnizimit pa krijuar vonesa dhe mbulimin në kohe dhe pa probleme të nevojave për oksigjen nisur dhe nga përvijat e mëparshme, Autoriteti Kontraktor do të lidhe me operatorin ekonomik fitues të dalë nga procedura e prokurimit, kontratë bazuar në nevojat e tij për këto mall çdo 6 muaj, në bazë të nevojave të Autoritetit Kontraktor

Shënim: Oksigjeni i bombolave që do të përdoren duhet të jetë i regjistruar në AKBPM për tregtim në Republikën e Shqipërisë.

Afati i skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet dates së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.

***Argumentim :** Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me nenin 36 pika 1 të ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se :1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 pika 38/b të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e e furnizimit të mallrave që do të prokurorhet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj si dhe me nenin 40 pika 2 të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe janë vendosur nga sektori teknik në përputhje me mallin që prokurorhet në rastin aktual për oksigjen të gazte, nuk janë diskriminuese dhe janë në përputhje me legjislacionin aktual në fuqi si dhe në përputhje me praktiken e ndjekur nga ministria e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale në rolin e OQB.*

Në seksionin e specifikimeve teknike, janë vendosur te njëjtat specifikime teknike të përcaktuara nga sektori teknik të cilët janë bazuar në praktiken e ndjekur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në rolin e OQB, të dokumentuara në procesverbalin përkatës në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Në lidhje me kushtet e veçanta për kualifikim, njësia e prokurimit është bazuar në ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ligjit nr.105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” i ndryshuar, ligjit nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion” akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi ,si dhe praktikes së MSHMS në raport me vlerën e kontrates, sasine e artikujve të kërkuar përcaktoi kriteret e sipërcituara si minimumin e kërkuar për t’u plotësuar nga operatorët ekonomikë

ILARGUMENTIM I KRITEREVE TE VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PER LOT 2 OKSIGJEN LENG

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1;
- d. Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, në të cilin është e percaktuar se: "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla."

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

- a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;
- b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në të cilin është e parashikuar se:

1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.
2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

d. Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipercituar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 29, 76, 82 dhe 83 të LPP, nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të përlllogaritur të lotit ku ofertohej / shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkurron.

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera do të aplikohet mbi vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është e percaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Ky kriter, është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020,"Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin percaktohet se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik

dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;

Ne vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, nenit 43 pika 1 dhe pika 2 germa "b", parashikohet marzhi maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, konkretisht:

Ne pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se:

Neni 43 Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetare

Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar bazuar ne vleren e fondit limit, AK ka marre parasysh praktikat e vendosur ndër vite te cilat kane rezultuar e suksesshme, lidhur me vendosjen e marzheve maksimale të përcaktuara nga legjislatori në Rregullat e Prokurimit Publik si dhe në Legjislacionin e Prokurimit Publik ne teresi. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; si dhe në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore **brenda dates 31 mars te vitit pasardhes, vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2023, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë patur afat deri më 31.03.2024.**

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore)

Gjithashtu ky kriter eshte vendosur bazuar ne VKM-se nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar Neni 42 "Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote" pika 3 dhe pika 9

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së lotit ku ofertohet / shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkurron.

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Permbushja e njerit prej kritereve të mesiperm e ben oferten të vlefshme

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me Ligjin nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" nenit 77 pika 4 ku percaktohet se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me Vendimin e Keshillit të Ministrave nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar neni 40 pika 4 ku percaktohet se: 4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" neni 77 dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" neni 40 pika 4 ku percaktohet se : 4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvajave të duhura, që janë në perpjesetim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontrates sic është parashikuar nga AK pasi në rastin aktual kemi të bëjmë me materiale mjekimi të një natyre teper te vecante

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvajave të duhura, që janë në perpjesetim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontrates sic është parashikuar nga AK

Gjithashtu ky kriter është vendosur bazuar në VKM-se nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar Neni 42 "Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote" pika 3 dhe pika 9

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvajave të duhura, që janë në perpjesetim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontrates sic është parashikuar nga AK

2.3.2 Certifikate ISO 9001-2015 ose ekuivalent, të vlefshme, për distribucionin e gazrave mjekesore të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, për fushën e aktivitetit të OE/ që perkon/ përputhet me objektin e Prokurimit

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter është në përputhje dhe me piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës. Gjithashtu ky kriter gjën mbeshtetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”. Gjithashtu ISO 9001: 2015 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanimit i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë, specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, për një organizatë e cila duhet të demonstrojë aftësinë e saj për të ofruar vazhdimisht produkte dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve dhe të zbatueshme ligjore dhe rregullatore, dhe ka për qëllim të rrisë kënaqësinë e klientit përmes zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e sistemit dhe sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat e konsumatorëve dhe kërkesat ligjore dhe rregullative). Të gjitha kërkesat e ISO 9001: 2015 janë të përgjithshme dhe kanë për qëllim të jenë të zbatueshme për çdo organizatë, pavarësisht nga lloji ose madhësia, ose produktet dhe shërbimet që ofron. Në rastin aktual është vendosur konformiteti të prokurimit.

2.3.3 Certifikate ISO 45001-2018, të vlefshme, për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter është në përputhje dhe me piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës. Gjithashtu ky kriter gjën mbeshtetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”. ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret furnizimi i gazrave mjekesore objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.4 Certifikatë ISO 14001:2015 –Sistemi i menaxhimit mjedisor ose ekuivalent, të vlefshme, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Argumentimi: Ky kriter është vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, ku percaktohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter është ne perputhje dhe me piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”i ndryshuar ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Ky kriter është i lidhur ngushte me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës.Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”.ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret furnizimi me gazra mjekesore objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

2.3.5 Kërkohet Autorizim (i vlefshëm për periudhën 2024 - 2025), lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit) ose nga Distributori i Autorizuar, nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tij në vendin tonë.Ne rastin e distributorit te autorizuar te provohet lidhja me prodhuesin nepermjet dokumentacionit perkates

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe ligjin nr.105/2014 “Per barnat dhe sherbimin farmaceutik” neni 11 pika 1 . Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Autorizim prodhuesi për tregëtim të materialeve objekt prokurimi, që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë furnizimin e mallrave objekt prokurimi në mënyrë cilësore sic parashikohen nga legjisllacioni në fuqi dhe që vlerësohet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.Autorizim prodhimi është dokumenti që i lëshohet prodhuesit farmaceutik, pasi ky i fundit ka vërtetuar se prodhuesi farmaceutik ka përmbushur të gjitha standardet e prodhimit, të cilësisë, ruajtjes dhe shpërndarjes së barit., pra është element sigurie per mallrat objekt prokurimi.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese/MAH ose distributor I autorizuar. Te plotesohet ne shtojcen 2, Lista e cmimeve te artikujve ose te paraqese nje deklarate e vecante mbi origjinen e mallit (Firma prodhuese ose distributori i autorizuar dhe vendi i prodhimit/origjines,)

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku percaktohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për

përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancise se furnizimit te mallit objekt prokurimi, pasi ne rastin aktual kemi te bejme me medikamnt i cili eshte i nje natyre teper te vecante.

2.3.7. Për barnat (e listës së DST) të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

/ose/

- autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe ligjin **nr.** “Per barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, neni 11 në pika 1 ku citohet: *1. Barnat që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë për përdorim njerëzor duhet të jenë të pajisura me autorizim për tregtim nga Agjencia.*

2.3.8. Për barnat (e listës së DST) të paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, bari që ofertohet duhet:

a. të ketë marrë autorizim për tregtim dhe të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar;

/ose/

b. të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm nëse ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tij,

/ose/

c. të jetë i pajisur me autorizim për tregtim nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA), ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Për këtë kërkohet që ofertuesi të paraqesë:

- Deklaratë me anën e të cilës të konfirmohet se bari që ofron, është i pajisur me autorizim për tregtim dhe qarkullon në një nga vendet e mësipërme (të Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar), ose që disponon autorizim për tregtim nga FDA ose EMA.

Në deklaratën e nëshkruar dhe të vulosur nga ofertuesi duhet të deklarohen: Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/eve të autorizuar që kanë lëshuar autorizimin për tregtim; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail, web-site); Numri dhe data e lëshimit të autorizimit për tregtim (nga Institucioni/et të autorizuar) të barit që ofron dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi.

Argumentim: Ky kriter vendoset në zbatim të Nenit 11, pika 2, të Ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, e cila, parashikon:

"2. Në raste nevojash të shërbimit shëndetësor (për mjekim ambulator dhe/ose spitalor), për barna të cilat nuk kanë asnjë alternativë të ngjashme, e cila ka autorizim për tregtim nga Agjencia, ministri përgjegjës për shëndetësinë autorizon importimin e barnave, për të cilat nuk është lëshuar autorizim tregtimi nga Agjencia, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave".

Gjithashtu, me qëllim garantimin e përmbushjes së standardeve mbi sigurinë, cilësinë dhe efikasitetin e barnave, edhe në rastin e barnave të paautorizuara, janë aplikuar të njëjtat kërkesa mbi origjinën e tyre, sikurse për barnat e autorizuar për tregtim. Kjo, duke u bazuar në Nenin 12, pika 2, të Ligjit Nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, e cila parashikon:

"2. Agjencia i propozon ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhënien e autorizimit të tregtimit për:

a) barnat e prodhuara në vendin tonë;

b) barnat që kanë marrë autorizim për tregtim dhe që qarkullojnë në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar;

b/1) barnat që kanë marrë autorizim për tregtim lokal dhe që qarkullojnë në vend, duke përmbushur përcaktimet e shkronjës “b” të pikës 2 të këtij neni.”.

c) barnat e prodhuara në vendet e Ballkanit, vetëm kur kanë marrë autorizim për tregtim dhe qarkullojnë në vendin e tyre;

ç) barnat e pajisura me autorizimin e tregtimit nga Agjencia Europiane e Barnave (EMA) ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.”

Në bazë të të dhënave të deklaruara , KVO është në gjendje të bëjë verifikimin e tyre.

2.3.9 Për barnat e parashikuara në pikën 2.3.7 të KVK të DST, kërkohet Autorizim (i vlefshëm për periudhën 2024 - 2025), lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tij në vendin tonë.

2.3.10 Për barnat e parashikuar në pikën 2.3.8 të KVK të DST, kërkohet Autorizim (i vlefshëm për periudhën 2024 - 2025), lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit) ose prodhuesi, ose distributori i autorizuar, nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre në vendin tonë.

Argumentim: Përsa i përket **kritereve 2.3.9 dhe 2.3.10** vendosen në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar (aftësia teknike), si dhe pika 3 e nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me qëllim zotërimin e reputacionit dhe besueshmërisë për zbatimin e kontratës. Afati i vlefshmërisë së autorizimit vendoset në përputhje me kohëzgjatjen e MK. Keto kërkesa dhe vecanerisht lidhja me distributorin për barnat e pa autorizuar për tregtim në RSH, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

2.3.11. Operatori ekonomik duhet të provojë se në se shpallet fitues, është në gjendje të sigurojë tanker oksigjeni për ta instaluar brenda 10 diteve nga lidhja e kontratës, pranë Autoritetit Kontraktore,. Kërkohen minimumi 1 (nje) tanker me kapacitet jo më të vogël se 5 000 litra.

- Në rastin kur OE i ka në pronesi, duhet të paraqesë një dëshmi për pronesinë mbi këto tankera (fature blerje ose dokument doganor për importimin e tankerave të oksigjenit ose çdo lloj dokumenti tjetër ligjor i cili dëshmon disponimin në pronësi të këtyre tankerave) dhe Vertetimin e lëshuar, për kontrollin e kushteve teknike dhe të sigurisë, për enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, konform legjislacionit në fuqi, ku të jënë përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotësimi i standarteve, kushteve teknike dhe të sigurisë. (*vërtetim, të vlefshëm i lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion) ose organet kompetente, për kolaudimin dhe plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë*)
- Në rast se tankerat e oksigjenit do të merren me qira, duhet të paraqitet kontrata ose marrveshja paraprake e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e kontratës, shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronesinë e pronarit të tankerave të oksigjenit si dhe Vertetimin e lëshuar, për kontrollin e kushteve teknike dhe të sigurisë, për enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, konform legjislacionit në fuqi, ku të jënë përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotësimi i standarteve, kushteve teknike dhe të sigurisë. (*vërtetim, të vlefshëm i lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion) ose organet kompetente, për kolaudimin dhe plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë*). Kontrata ose marrveshja paraprake e qirase duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë kohës së marrveshjes kuader.

*** Ky kriter konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e emrit të Inxhinierit nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.**

Shenim:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas

përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.**

Shënim: Në rastin e autorizimeve të lëshuara nga distributorët e autorizuar, duhet të provohet me dokumente lidhja e tyre (distributorëve të autorizuar) me prodhuesin/MAH (mbajtësin e autorizimit të tregtimit).

Argumentimi: Ky kriter vendoset në mbështetje të pikës 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe me pikën 8 të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar dhe behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet pasjes së burimeve/kapaciteteve të mjaftueshme për furnizimin me sasinë dhe llojin e kërkuar nga AK dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar në DST gjithashtu bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar është kërkuar që kjo pikë të quhet e përmbushur me deklarinimin në formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 me qëllim mospenalizimit e asnjë operatori ekonomik të interesuar.

Argumentimi i specifikimeve teknike për Lot . 2 Oksigjen i lenget

1	2	3	4	5	6
Nr	Sistemi	Principi aktiv	Formë doza	Njësia	Sasia e pritshme per 12 muaj
Lot . 2	Anestezi reanimacion	Oksigjen I lenget	Gaz për përdorim mjekësor, i lengshëm x 100%	Litra	141 857.8

Sasitë e pritshme të shënuara janë të përafërta, llogaritur për një periudhë 12 mujore (1 vit), dhe nuk janë në asnjë mënyrë detyruese për Autoritetin Kontraktor. Ato janë vendosur me qëllim vlerësimin e njëjtë të të gjitha ofertave të Operatorëve Ekonomikë.

LOT 2 OKSIGJEN LENG- Kërkesat për furnizimin janë si më poshtë:

II. Kushtet e furnizimit.

Automjetet

Furnizimi duhet të bëhet me autobotet e furnizuesit të pajisur me :

- Leje për Transport gazra mjekësore nën presion, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.
- Certifikatë miratimi ADR të lëshuar nga DPSHTRR.

Tankerat e Oksigjenit

- Tankerat duhet të certifikohen nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion) dhe duhet të nënshtrohen inspektimeve sipas afateve të përcaktuara ligjore.

- Furnizimi dhe depozitimi i Oksigjenit të lenget do të bëhet në përputhje me kushtet teknike dhe të sigurisë, në tankerat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Fier.

- Kapaciteti i Tankerit jo më i vogël se 5 000 litra për godinën qendrore të Spitalit

Gaz per perdorim mjeksor, i lengshem,

- Mbeshtetur ne detyrimin per te furnizuar mallin (oksigenen i lenget) te ambalazhuar sipas kushteve teknike, Operatori Ekonomik duhet te furnizojë dhe montojë prane AK, tankerat , të cilët do te jete ne perdorim të AK deri ne perfundimin e Marrëveshjes Kuadër.
- OE ka detyrimin per certifikimin e Tankerave në Inspektoriatin Shteteror Teknik dhe Industrial (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion), rregjistrimin dhe ndjekjen e kryerjes se inspektimeve sipas afateve te percaktuara ligjore.
- Operatori Ekonomik eshte pergjegjes per pajisjen e Ak me tanker, montimin, lidhjen e tij me rrjetin oksigjenit, kontrollin dhe mirembajtjen ne perputhje me kushtet teknike dhe legjislacionin ne fuqi.
- Aparatet matese te depoziatave/tankerave te jene te kolauduara nga institucionet kompetente. Me lidhjen e MK, ti vihet dokumentacioni i kolaudimit te aparatave matese, grupit te punes te marrjes ne dorezim te mallit nga OE.

III. Kërkesa të veçanta

1. Brenda 10 ditëve nga lidhja e Marrveshjes Kuader, Operatori Ekonomik fitues, ne marreveshje me AK, duhet të realizojë furnizimin dhe montimin e tankerave prane AK si dhe lidhjen e tij me rrjetin oksigjenit. Pas instalimit te tankerit, OE fitues duhet te kryejë rregjistrimin dhe certifikimin e tij prane **Inspektoratit Shteteror Teknik dhe Industrial**.
2. Per periudhen e zgjatjes se punimeve, kontraktori duhet te marrë masat për të mos nderprerë furnizimin me oksigjen të shërbimeve spitalore, duke furnizuar më parë rampat e oksigjenit të gaztë me bombola 40 litershe me presion 125 bar, sipas nevojave te spitalit.
Sasia e oksigjenit mjeksor të gaztë të konsumuar gjatë ditëve të instalimit të tankerave do të konvertohet në oksigjen të lëngët sipas normativave teknike.
3. Operatori ekonomik duhet te sigurojë, ne rast avarie te tankerit te oksigjenit lëng, furnizimin me tanker rezerve ose me bombola oksigjeni mjeksor gaz, në rampat e oksigjenit të gaztë, për te siguruar gadishmerine e furnizimit me oksigjen te shërbimeve spitalore 24/24 sipas nevojave te AK. Sasia e oksigjenit mjeksor të gaztë të konsumuar gjatë kesaj periudhe do të konvertohet në oksigjen të lëngët sipas normativave teknike.
Shenim: Oksigjeni i bombolave qe do te perdoren sipas pikes 2 duhet te jete i regjistruar ne AKBPM per tregtim ne Republikën e Shqiperise.

Transportimi dhe shkarkimi i mallit eshte pergjegjesi e shitesit

- Autoriteti Kontraktor harton grafikun mujor të lëvrimit të mallit, një kopje e të cilit i jepet furnizuesit në fund të çdo muaji për muajin pasardhës. Në cdo rast duhet lajmëruar furnizuesi dy ditë më parë.
- Për arsye të krijimit të një sigurie në kryerjen e furnizimit pa krijuar vonesa dhe mbulimin ne kohe dhe pa probleme te nevojave per oksigjen nisur dhe nga pervojat e meparshme, Autoriteti Kontraktor do te lidhe me operatorin ekonomik fitues të dalë nga procedura e prokurimit, kontratë bazuar në nevojat e tij për kete mall çdo 6 muaj, në bazë të nevojave të Autoritetit Kontraktor

Shenim: Oksigjeni duhet te jete i regjistruar ne AKBPM per tregtim ne Republikën e Shqiperise.

Afati i skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet dates së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.

Argumentim : Specifikimet teknike jane vendosur ne perputhje me nenin 36 pika 1 te ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" ku percaktohet se :1. Specifikimet teknike, siç percaktohen në nenin 4 pika 38/b të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike percaktohen qartë karakteristikat e e furnizimit te mallrave që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj si dhe me nenin 40 pika 2 te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar dhe jane vendosur nga sektori teknik ne perputhje me mallin qe prokurohet ne rastin aktual per oksigjen te gazte, nuk jane

diskriminuose dhe jane ne perputhje me legjislacionin aktual ne fuqi si dhe ne perputhje me praktiken e ndjekur nga ministria e shendetesise dhe mbrojtjes sociale ne rolin e OQB.

Në seksionin e specifikimeve teknike, jane vendosur te njëjtat specifikime teknike të përcaktuara nga sektori teknik te cilet jane bazuar ne praktiken e ndjekur nga Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale ne rolin e OQB, të dokumentuara në procesverbalin perkates në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Në lidhje me kushtet e veçanta për kualifikim, njësia e prokurimit eshte bazuar në ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, ligjit nr.105/2014 “Per barnat dhe sherbimin farmaceutik” I ndryshuar, ligjit nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion” akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi ,si dhe praktikes se MSHMS në raport me vleren e kontrates, sasine e artikujve te kërkuar përcaktoi kriteret e sipercituara si minimumin e kërkuar për t’u plotësuar nga operatorët ekonomikë

Njesia e prokurimit, referuar nenit 42 pika 5 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 i ndryshuar përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si me poshtë :

Afati i fundit per pranimin e dokumentave dhe data e zhvillimit te tenderit, do te jete data 06.09.2024 ora 10:00. Vendi www.app.gov.al; Spitali Fier.

(Mbeshtetur ne piken 5 te nenit 42 te ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar. 5. Për procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, afati për pranimin e ofertave është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e njoftimit të kontratës dhe, në rast se ofertat paraqiten me mjete elektronike, ky afat mund të shkurtohet me 5 ditë.” si dhe duke pasur parasysh se shpallja e njoftimit te kontrates ne faqen e internetit te APP-se behet publike ditën e neserme te punes nga dita e hedhjes ne sistem te njoftimit, afati i vendosur nga NjP eshte brenda afatit ligjor perkates).

NJESIA E PROKURIMIT